

Masa përkrahëse në shkollë

– ÇKA KAM NEVOJË TË DI SI PRIND?



Ti je i rëndësishëm

Ti je ai/ajo që i qëndron fëmiut tuaj më së afërmi. Andaj është e rëndësishme që ti dhe shkolla e fëmijës të keni një bashkëpunim të mirë rreth zhvillimit të fëmijës suaj. Përmes bashkëpunimit shtohet mundësia e fëmijës që të arrijë shumë si në zhvillimin e diturisë ashtu edhe në atë social.

Duke e ditur misionin e shkollës atëherë rriten mundësitë për të bashkëvepruar me shkollën e fëmijës tuaj. Në këtë broshurë do të marrësh njoftime se çka mund të presësh nëse fëmija i juaj ka nevojë për përshtatje ekstra apo ndihmë të posaçme në shkollë. Kjo broshurë të drejtohet ty që ke fëmijë në klasën parashkollore, shkollën fillore, shkollën fillore të posaçme, shkollën speciale, shkollën same, shkollën e mesme, shkollën e posaçme të mesme apo në kopshtin e kohës së lirë.

KONCEPTET PRIND DHE KUJDESTAR

- Zakonisht është njëri apo të dy prindërit kujdestar të një fëmiju. Kujdestari e ka përgjegjësinë për fëmijun dhe duhet të kujdeset që fëmija të ketë një siguri, përkujdesje dhe edukim të mirë. Kujdestari i një fëmije ka pothuaj gjithmonë të drejtë të informohet për të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me fëmijën në shkollë, edhe për gjëra që janë konfidenciale. Një prind i cili nuk është kujdestar nuk ka të drejtë të marrë të dhëna që janë konfidenciale e që bëjnë fjalë për fëmijun.

KODI PRINDROR DHE LIGJI PËR ÇËSHTJE SEKRETE DHE PUBLIKE

Në rrugë për të njëtën synim

Ligji për shkolla dhe plani mësimor parashtrajnë kërkesa të mëdha ndaj institucioneve arsimore që të gjithë nxënësve tu jepet arsimim i barazvlefshëm të kualitetit të mirë pavarisht se ku banojnë dhe në cilën shkollë shkojnë. Në planin mësimor përshkruhen vlerat bazë të shkollës, objektivat e përgjithshme dhe misioni i tyre. Duke e lexuar atë ti njoftohesh për pritjet dhe kërkesat që mund t'i keshë.

Çdo plan kursi dhe plani i lëndëve shkollore përshkruajnë arsyen se pse kjo fushë mësimore ekziston në shkollë. Aty përshkruhet edhe përmbajtja e mësimdhënies



përkrahje të posaçme. Zakonisht hetimi bëhet nga mësuesi me personel nga shëndetësia e shkollës.

Hetimi përbëhet nga shtjellimi i situatë shkollore të nxënësit dhe një analizë rreth nevojës për përkrahje të posaçme. Është e rëndësishme që shkolla të marrë parasysh mendimet e tuja dhe të fëmijut tuaj. Një hetim nganjëherë mund të bëhet shpejt dhe thjesht por nganjëherë kërkohen hetime më të thella. Më e mira është që të bashkëpunohet me prindërit kujdestar por shkolla mund të bëjë një hetim pedagogjik edhe nëse prindi kujdestar nuk e do një gjë tillë.

Përkrahja e posaçme jepet për një kohë më të gjatë dhe me përmasa më të mëdha. Shembull i përkrahjes së posaçme mund të jetë një mësues special që punon me nxënësin për një kohë më të gjatë, grupe të posaçme mësimore ose që një asistent ta përcjell nxënësin gjatë pjesës më të madhe të ditës në shkollë.

Përkrahja e posaçme dokumentohet në një program të masave

Nëse hetimi tregon se nxënësi ka nevojë për përkrahje të posaçme atëherë shkolla duhet ta përpunojë një program masash.¹ Hetimi mund poashtu të tregojë se nxënësi nuk ka nevojë për përkrahje të posaçme dhe atëherë drejtori i shkollës e merr vendimin që të mos hartohet programi i masave.

Programi i masave është një vegël e punës dhe një plan se cilat masa e ka ndërmend t'i realizoj shkolla. Në programin e masave duhet të ketë edhe informacion se kur ky program duhet të vlerësohet. Vlerësimi bëhet me qëllim për të shikuar se si masat kanë funksionuar. Shkolla e ka vetëm një program masash për një nxënësi pavarësisht se sa lëndë apo fusha mësimi apo kurse përfshihen nga përkrahja e posaçme. Ty dhe fëmijut tuaj duhet ofruar mundësia që të merrni pjesë dhe të shfaqni mendimet e tuaja me rastin e hartimit apo vlerësimit të programit të masave.

Ankesa ndaj një vendimi

Ti si prind kujdestar dhe nxënësit mbi 16 vjeç keni të drejtë të ankoheni kundër një vendimi rreth programit të masave në Komisionin për Ankesa të rrejtët shkollor.

¹ 3 nen. 8 dhe 9 §§ ligjimi shkolla 2010:800.



A do të lexosh më shumë?

Ligji mbi shkolla (2010:800) dhe *Këshilla të përgjithshme për të punuar me përshtatshmëri ekstra dhe përkrahje të posaçme* e Entit Shkollor gjenet për t'a shkarkuar në uebsajtin www.skolverket.se.

Originalalets titel: Stödinsatser i skolan

Grafisk produktion: Typisk Form designbyrå

Illustrationer: Tobias Flygar

Skolverket 2015

Skolverket